

FTESË PËR OFERTË

Kreditimi Rural i Kosovës (KRK) është institucion mikrofinanciar i cili me qëllim të zgjedhjes së kompanisë për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve për vitin 2021, fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin ofertat e tyre për:

SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E E AUTOMJETEVE

Kreditimi Rural i Kosovës ka gjithsej **75 vetura**, prej tyre 56 vetura të markës Volkswagen (Golf dhe Polo) 1 veturë të markës Opel dhe 7 Seat Ibiza, 4 Skoda Octavia 2017-2019 dhe 7 Toyota Auris

Veturat janë të bazuara në komunat e Kosovës siq vijon: Deçan, Ferizaj, Gjakovë, Gjiilan, Gllogoc, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Dragash, Kamenice, Fushe Kosovë dhe Obiliq.

Numri i veturave mund të ndryshoj gjatë vitit.

Ofertat për servisim dhe mirëmbajtje të automjeteve do të vlerësohen sipas kushteve dhe kriterëve të poshtëshënuara:

1. Çmimi me i volitshëm i pjesëve rezerve dhe shërbimeve (çmimet duhet të jenë për njësi dhe në çmim të përfshihet TVSH),
2. Prejardhja e pjesëve rezerve,
3. Eksperiencës së ofertuesit në punët e servisimit dhe mirëmbajtjes,
4. Garancioni për pjesët rezerve dhe shërbimet e ofruara,
5. Disponimi i aparaturës kompjuterike për diagnostifikim të defekteve të automjeteve.
6. Posedimi i serviseve në komunat apo afërsi të komunave ku janë të bazuara veturat e KRK-se.

Ofertuesit duhet të paraqesin listën e çmimeve të shërbimeve të zakonshme për servisim të rregullt, mirëmbajtje duke përfshirë punën dhe pjesët rezerve.

Kontrata me ofertuesin e suksesshëm do të lidhet me afat një vjeçar me mundësi ripërtëritje.

Afati për paraqitjen e ofertave është nga data **11.12.2020** deri me datën **18.12.2020**, në adresën e më poshtme: **Kreditimi Rural i Kosovës LLC / Rr. Behije Dashi, Nr.20 / 10000 Prishtinë** apo përmes email adresës **krk_imf@krk-ks.com**.